



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1705/2 Prot.

Tiranë, më 26 / 12 / 2018

**V E N D I M**

**Nr. 261, Datë 26 / 12 / 2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 186, datë 11.12.2018, të paraqitur nga M.S kundër Consulcesi Service sh.p.k, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga M.S, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas informacionit të dhënë, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, ka qenë në marrëdhënie punësimi me kompaninë Consulcesi Service sh.p.k nga data 29.11.2016 deri me datë 19.05.2017, nga ku është larguar për arsye personale dhe është rikthyer pranë të njëjtës kompani në datë 06.09.2017 deri në datë 29.01.2018, datë në të cilën është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të thyerjes së besimit mes palëve. Ankuesja informon se gjatë periudhës së punësimit ka pasur situata të shumta dhe sistematike në të cilat sjellja e përgjegjësve të kompanisë ndaj ankuses kanë qenë denigruese, diskriminuese, ofenduese, psikologjikisht të dhunshme, por dhe duke shkelur privacinë e saj. Disa nga këto raste ankuesja i shpegon si më poshtë:

- Gjatë tri muajve të parë të punës si punonjëse në periudhë prove, përgjegjësi i punës R.B, i është drejtuar me batuta fyese, si psh: “Puno skllave” dhe “Skllavja Izaura”.
- Në muajin shkurt 2017 është zhvilluar një takim mes saj dhe punëdhënësit për ta informuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë gjithë takimit është sulmuar rregullisht me pretendimin se nuk është e sjellshme në punë, që ka probleme të forta me kuptimin e situatave, sjelljeve dhe personave, është mendjemadhe dhe duke theksuar se ka probleme me mbivlerësimin e vetes dhe personalitetin.
- Që prej momentit kur është rikthyer në punë, në datë 06.09.2017, ka vënë re se është trajtuar ndryshe nga kolegët e tjerë. Përgjegjësi, A.Sh disa herë i është drejtuar me tone të larta, pa asnjë arsye. Përgjegjësi A.Sh i ka thënë ankuses se i është kërkuar në mënyrë direkte që ta mbajë në vëzhgim, të monitorohej dhe të mos trajtohej si të tjerët pasi nuk ishte mirëpritur rikthimi i saj pranë kompanisë.

- Në datë 28.12.2017 ka zhvilluar një takim me përgjegjësen, F.N ku ka qenë prezent dhe N.Z (account manager), për të diskutuar për mungesën që kishte bërë nga data 18 deri 22 dhjetor 2017 dhe paraqitjen e raportit mjekësor për këto data. Gjatë takimit F.N e ka informuar se posedon një foto të marrë nga profili i M.S në rrjetin social Instagram, në të cilin provohet se ankuesja ka qenë jashtë shtetit. Ngjarje e cila është bërë shkas për fillimin e procedurave për largimin e ankueses nga puna.

Ankuesja shprehet se këto janë disa nga situatat e vështira që i është dashur të përballojë gjatë marrëdhënieve të punës, situata të shprehura me sjellje të jashtëligjshme të cilat kanë pasur për qëllim që ta diskriminonin, diskretitonin, ta izolonin, fyenin duke i cënuar nderin dhe personalitetin. Kjo sjellje e koordinuar e të gjithë aktorëve drejtues pranë kompanisë Consulcesi Service sh.p.k, i kanë shkaktuar ankueses shqetësime të karakterit socio-emotiv dhe psiko-fizik.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkaqet e pretenduara dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm në krahasim me punonjësit e tjerë.

Në datë 14.12.2018, subjekti ankues është paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe e pyetur nga inspektori i çështjes për të shpjeguar shkaqet e diskriminimit të pretenduara dhe trajtimin e pabarabartë në krahasim me punonjësit e tjerë, shpjegoi se: “Ka pretenduar për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, pasi nuk i është dukur normale që të mos fliste për diçka që nuk e pëlqente si dhe për “çdo shkak tjetër” si presione dhe shqetësime të ardhura nga karakteri i saj i vëshirë<sup>1</sup>”. Ankuesja dorëzoi dhe këto dokumente: - Librezë pune. – Shkresë, Njoftim për takim, datë 08.01.2018. – Shkresë, Kthim përgjigje nr.160, datë 06.04.2018, të Degës Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Qarku Tiranë. – Shkresë, Kthim përgjigje nr. 160/2, datë 07.05.2018, të Degës Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Qarku Tiranë. – Shkresë, Vendim për mosfillimin e procedimit nr. 6667, datë 06.06.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Me e-mail-in datë 18.12.2018, ankuesja ka dërguar, shkresën datë 15.01.2018, Njoftim për zgjidhjen e kontratës, të punëdhënësit “Consulcesi” dhe përgjigjes së marrë nga portali “Shqipëria që duam”.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

<sup>1</sup> Referuar Procesverbalit, datë 14.12.2018.

*vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përvajshim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesja për të provuar shkakun e përkatësisë në një grup të veçantë, nuk ka paraqitur asnjë parashtrim apo provë lidhur me përkatësinë në një grup të veçantë të cilët kanë veçori të posaçme dhe janë objekt paragjykimesh për të cilët duhet dhe një shkallë e posaçme e mbrojtjes ligjore<sup>2</sup>.

Gjithashtu, ankuesja në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë parashtrim apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit, “çdo shkak tjetër” që të mund ta provonte atë.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, çka është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh<sup>3</sup>.

Referuar praktikës së GJEDNJ-së, ajo ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. Ky arsyetim mund të na shërbejë për analogji edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes me “çdo shkak tjetër”, të

<sup>2</sup> Në rastin Kiyutin kundër Rusisë (App no.2700/10), GJEDNJ-ja ka pohuar se personat që jetojnë me HIV, i përkasin një grupi vulnerabël.

<sup>3</sup> Neni 14, i KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*

parashikuar në nenin 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. “Çdo shkak tjetër” nuk është shkak më vehte.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në datë 14.12.2018 dhe më e-mailin e datës 18.12.2018 të subjektit ankues, ankuesja ka dërguar dokumentacion shtesë, por sërish nuk ka sjellë asnjë parashtrim apo provë për të faktuar shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “...ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së shtetases M.S, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**